



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:263236  
Datë: 02.04.2024  
Numri i dokumentit: 05529924

PKR.nr.80/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, me trupin gjykues të përbërë nga kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Mentor Hajraj, me anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët: Genc Hasani dhe Benita Berisha me zyrtaren ligjore Arijana Bislimi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.B , për shkak të veprës penale Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.95/22 e datës 06.04.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 18.03.2024, e cila ka qenë e hapur për publikun, ku kanë prezantuar prokurori i shtetit: Sahit Tmava, i akuzuari N.B dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Fitim Vokshi, të njëjtën ditë në prezencën e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij publikisht ka shpallur, ndërsa me dt.02.04.2024, ka përpiluar me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit: N.B, nga i ati Sh..., e ëma Z..., e gjinisë M..., i lindur më datë ....., në Mitrovicë , ndërsa me vendbanim në fshatin ..... ne rrugën “.....”, komuna e Vushtrrisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin e ndërtimtarisë, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal \*\*\*\*\*.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 06.10.2019 rreth orës 19:00 min. në fshatin .....-....., saktësisht në shkollën fillore “.....”, i pandehuri N..... në qendrën e votimit 2727B, gjatë mbajtjes së Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në cilësinë e Kryesuesit të vendvotimit me numër 2727B/01R, duke e keqpërdor pozitën, detyrën apo autorizimet e tij lidhur me zgjedhjet, pas mbylljes së vendvotimit ka shtuar dhe hequr votat e kandidatëve brenda subjekteve politike gjatë numërimit të fletëvotimeve, në atë mënyrë duke i hequr votat e disa kandidatëve dhe duke

iu shtuar disa kandidatëve tjerë i regjistron në mënyrë të pasaktë dhe atë gjithsej 229 vota, 78 vota të shtuara dhe 151 vota të hequra: të shtuara PDK 14 vota, NDS 2 vota, AAK-PSD 100%-KOSOVË 29 vota, NISMA-AKR 1 votë, LVV 20 vota, LDK 12 vota, dhe të hequra PLE 9 vota, PDK 33 vota, NISMA-AKR 4 vota, LVV 88 vota, PEE 3 vota GIG 2 vota, LDK 8 vota dhe SP 4 vota.

Me këtë ka kryer veprën penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-se.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 7, 17, 21, 46, 47, 48, 49, 69, 71 par.1 pika 1.3, 72 par.1 pika 1.3 dhe neni 216 par.2 të KPRK-së, lidhur me nenet 364, 450 dhe 452 të KPP-së:

## S H Q I P T O N

I. DËNIM TE KUSHTEZUAR, me te cilin te akuzuarit i përcaktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale në afatin prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

II. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe shumen prej 50 (pesëdhjetë) euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

III. Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk pati, andaj për realizimin e kërkesën pasurore juridike, gjykata nuk vendosi fare.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr. 95/2022 e datës 06.04.2023, ndaj të akuzuarit N.B, për shkak të veprës penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor më datën 18.13.2024, në të cilën ka prezantuar Prokurori i Shtetit Sahit Tmava, i akuzuari N.B dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av.Fitim Vokshi, ku janë ndërmarrë veprimet përkatëse juridike.

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 18.03.2024 i akuzuari është udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tij konform nenit 319 të KPP-së, pas deklarimeve të të akuzuarit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga prokurori i shtetit, më pas i akuzuari është deklaruar se e kupton akuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe pas bindjes së kryetarit të trupit gjykues se i akuzuari e ka kuptuar akuzën, dhe pasi që është njoftuar për pasojat dhe benificionet që parasheh ligji lidhur me pranimin e fajësisë, i akuzuari është deklaruar se e ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, dhe pasi që gjykata e ka njoftuar me të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me pranimin e fajësisë në shqyrtimin e mbajtur gjyqësor, i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat ligjore rreth pranimin të fajësisë dhe rrethanat lehtësuese që i merr gjykata andaj ka qëndruar rreth pranimin të fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, i ka kuptuar pasojat e kryerjes se veprës penale dhe pas sqarimit të gjykatës, kurse pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat e tjera materiale, andaj i propozoi gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Mbrojtësi i te akuzuarit av.Fitim Vokshi, sa i përket pranimin te fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se e mbështes në tërësi deklarimin e klientit tim për pranimin e fajësisë dhe i propozon gjykatës që të njëjtën t'ia aprovojë.

Pas pranimin te fajësisë nga i akuzuari dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i te akuzuarit, trupi gjykues është bindur se i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, andaj trupi gjykues në procesverbal në kuptim të nenit 322 lidhur me nenin 242 par.2 e lidhur me par.6 të KPP-së, ka marrë aktvendim duke miratuar pranimin e fajësisë në fazën e shqyrtimit gjyqësor, pasi që i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale te cilat gjenden ne shkresat e lendes.

Prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij nuk kanë pasur propozime apo plotësime në këtë çështje penale dhe pasi që Gjykata ka miratuar pranimin e fajësisë për veprën penale nga i pandehuri dhe meqenëse nga palët nuk ka pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës, trupit gjykues shqyrtimin gjyqësor ka vazhduar me paraqitjen e fjalës përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kryerja e veprës penale si në aktakuzë nga i pandehuri është provuar nga provat të cilat edhe është ngritur aktakuza, fakte këto të cilat i ka vërtetuar dhe vet i pandehuri me pranimin e fajësisë dhe tutje ka deklaruar që me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata të merr të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me ligj.

Mbrojtësi i te akuzuarit, av.Fitim Vokshi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: i mbrojturi im që nga fillimi i procedurës kundër tij e ka ndjerë veten fajtor, ka qenë i penduar ku edhe ka pranuar fajësinë pasi që është sqaruar për benefitet e pranimit të fajësisë dhe lut gjykatën të ketë parasysh se edhe nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar gati 5 vite i njëjti ka deklaruar se mosha e shtyre e të akuzuarit të llogaritet si masë lehtësuese ndaj tij dhe që të njëjtit ti shqiptojë një dënim sa më të butë .

I pandehuri N.B në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij dhe se i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsëris më vepra penale.

Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i akuzuari në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 360 të KPP-së, Gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova se në veprimet e të akuzuarit kemi të bëjmë me elementet e veprës penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së, me të cilën akuzohet sipas aktakuzës, kjo konstatohet nga provat që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale të cilat gjenden në shkresat e lëndës: Librin e votimit (kopje) për vendvotimin nr.2727B/01R, Formulari (kopje) i përputhjes se të dhënave të rezultateve (FPR) e krijuar në vendvotimin nr. 2727B/01R dhe FPR-në e rinumëruar QNR (kopje), Formulari (kopje) i përputhjes se të dhënave të rezultateve të kandidatëve (FRK) e krijuar në vendvotimin nr. 2727B/01R dhe FRK e rinumëruar në QNR (kopje),Tabela (në Excel) e specifikuar me emrin e kandidatit, subjektin politik dhe pasqyra e votave të numëruara në vendvotim dhe rezultati pas rinumërimit në QNR (votat të cilat janë shtuar apo hequr në detaje), deklarata e të pandehurit, si dhe shkresat tjera të lëndës, andaj të gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të

përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen-krijohen elementet e veprës penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së të gjitha rrethanat si me lart tregojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Duke vlerësuar përgjegjësinë penale të të akuzuarit në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të akuzuarit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin për të përjashtuar përgjegjësinë penale të të akuzuarit në këtë çështje.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 të KPRK-së, Gjykata si rrethanë lehtësuese vlerësoj pranimin e fajësisë nga i akuzuarit, shprehjen e keqardhjes se i akuzuari është penduar për veprën të cilën e ka kryer, bashkëpunimin e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale, pastaj faktin se i njëjti është familjar, ndërsa rrethanë rënduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë të të akuzuarit.

Në rastin konkret kundër këtij të akuzuari gjykata vendosi që të aplikoj dispozitat e zbutjes së dënimit dhe të njëjtit i shqiptoj-përcaktojë dënimin me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit nën minimumin e paraparë ligjor për këtë vepër penale, e pastaj te njëjtin e ka kushtëzuar, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 71 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, pasi që në rastin konkret i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ai akuzohet sipas aktakuzës.

Gjykata zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarës e ka bërë në kuadër të kufijve për zbutjen e dënimit të paraparë në dispozitën ligjore nga neni 72 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, në të cilën parashihet “nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”. Në rastin konkret për veprën penale për të cilën i akuzuar N.B është shpallur fajtor për shkak të veprës penale *Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK-së*, është paraparë dënimi me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet. Pra siç shihet për këtë vepër penale kufiri i zbutjes së dënimit ka qenë dënimi me burgim prej një (1) viti.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i kushtëzuar i cili i është shqiptuar të akuzuarit është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i akuzuari dhe se gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet

qëllim i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, se i akuzuari në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 dhe 452 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 36 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk pati, andaj gjykata për kërkesën pasurore juridike nuk vendosi fare.

Nga të cekurat si më lart, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.80/2023, të datës 02.04.2024

Procesmbajtësja:  
Arijana Bislimi

Kryetari i trupit gjykues  
Mentor Hajraj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.